



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më 09.07.2025

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturina të qytetit të Pogradecit dhe Njësive Administrative”.

Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat (48 dyzet e tetë) muaj.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Sherbime pastrimi: 98341130-5*

*Sherbime të grumbullimit të mbeturinave: 90511300-5*

*Sherbime të grumbullimit të mbeturinave shtëpiake: 90511200-4*

*Sherbime të transportit rrugor: 60100000-9*

**VLERA E FONDIT LIMIT:** Fondi limit i Marrëveshjes kuader për 48 muaj/Vlera e pritshme e kontratës/kontratave është **436 332 183 (katërqind e tridhjetë e gjashtë milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 4 457 828 (katër milion e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet e tetë) Euro.**

Kursi i këmbimit 97.88 Lek/Euro, sipas kursit të Këmbimit të datës 08.07.2025.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Pogradec, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

Neni 83, i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël".

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik, sipas Shtojcës 10.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontratës.

*Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete sa vlera e përlllogaritur e fondit limit, që është

*brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenit 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

**2.2.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

*Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri

audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: i) faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjithë zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara; ii) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.*

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit, i cili duhet të jetë i punësuar me kohë të plotë (sipas përcaktimeve të VKM nr.538 datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen

nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta).

Për drejtuesin Teknik të kërkuar të paraqitet:

- a) Diplomë
- b) CV përkatëse
- c) Kontratë pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** *“Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.*

*Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij, është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vertetohen në CV perkatese të tij. Kriteri I mesipër për eksperiencën e drejtuesit teknik është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) me Leje III.B, si me poshte, të shoqeruara me akt miratimin përkatës.

- Kategoria III.1.B “Për ndikimin në Mjedis”, Nenkategoria Leje Mjedisi tipi B “Magazininim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontenierët ose nga larjet e kontenierëve.

- Kategoria III.2.B "Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane".

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në piken 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të*

*Prokurimit Publik”, e ndryshuar, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011” Per mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”. Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat e mesiperme te kerkuara jane ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike. Ne kuader te zbatimit te kontrates per pastrimin e mbetjeve urbane apo mbetjeve te tjera jo te rrezikshme, operatori ekonomik duhet te permbushë detyrimet ligjore ne perputhje me ligjin nr. 10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit, dhe ligjin nr. 10463, date 22..09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, I ndryshuar. Nje nga hallkat e rendesishme te ketij procesi eshte mbledhja, dhe transportimi I konteniereve te cilet hiqen nga vendi i qendrimit dhe dergohen per tu lare dhe dezinfektuar. Leja mjedisore III.1.B siguron qe magazinimi te behet ne menyre te kontrolluar dhe te sigurt per mjedisin. Kjo leje garanton qe subjekti ka kapacitete teknike, infrastrukture dhe masat per te minimizuar ndotjen dhe impaktin ndaj ambientit. AK ka kerkuar disponimin e kesaj leje per te garantuar se operatori mund te kryeje te gjitha fazat e sherbimit sipas ligjit. Pa nje leje te tille, ekziston rreziku per depozitim te pakontrolluar te mbetjeve, gje qe mund te coje ne ndotje, perhapje infeksionesh apo shqetesime per komunitetin. Kjo leje eshte thelbësore per proceduren e prokurimit pasi garanton qe operatori eshte ne gjendje te trajtojë mbetjet ne menyre te ligjashme, te sigurt dhe te qendreshme per mjedisin edhe ne rastet kur nuk eshte i mundur transporti i mbetjeve per ne Landfill dhe nevojitet magazinimi i perkohshem i tyre. Lloji dhe kategoria e lejes së mjedisit të kërkuar, licenca me (kodi III.2.B) është në përputhje me zërat e realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike, ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane në venddepozitimet përkatëse.*

**2.3.4** Operatori ekonomik, për kryerjen e shërbimit të pastrimit objekt prokurimi, duhet të ketë të punësuar mesatarisht 70 (shtatedhjete) punonjës, si me poshte:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisit ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit)
- 2 (dy) Manovrator
- 12 (dymbëdhjete) Shofere
- 55 (pesëdhjete e pese) punonjës shërbimi

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Inxhinieri i Mjedisit/ eksperti: Kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.
- Shoferët: Kontratë pune e vlefshme, leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale.

-Manovratore: Kontratë pune e vlefshme, leje drejtimi, deshmi e aftësisë profesionale.

- Gjithashtu për përmbushjen e këtij kriteri, te gjithë punonjësit e mesiperm duhet të figurojnë në listepagesën e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të tenderit dhe të paraqesin:

-Vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shendetesore për Tatimpaguesin, të lëshuar nga Administrata Tatimore,

- Listepagesat e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shendetesore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi.

*Shënim:Në rastin kur punonjësit shofere janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qira, nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).*

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011”Për mbrojtjen e mjedisit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në analizën e çmimeve, volumin dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe

profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Fuqia punetore është përllëgaritur bazuar në legjislacionin në fuqi, e argumentuar nga grupi i punës se përllëgaritjes se fondit limit.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë certifikatat ISO, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001-2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor
- ISO 45001 -2023 Sistemet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë

mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit. ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale punë të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Shënim: Disponimi i punonjesit "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të kontraktimit të një punonjësi të pajisur me certifikatën si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", kontrata duhet te jetë e vlefshme gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës se shërbimit.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë....."Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DT, duke respektuar

çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që shërbimi të realizohet brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të ofrojnë shërbimin sipas standarteve ligjore në fuqi. Gjithashtu është e nevojshme për të siguruar kushte të sigurta pune për punëtorët dhe për të respektuar rregulloret e sigurisë.

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet tipi (emërtimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si më poshtë:

a. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 10 deri në 12 ton, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi);

b. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet transportues 5-7 ton, jo më pak se 6 (gjashtë) copë, (në pronësi / me qira / porosi);

c. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi);

d. Makina për larjen e rrugëve, (autobot), me kapacitet mbajtës jo më pak se 10000 litra ujë, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi);

e. Kamioncine me kapacitet transportues 1 deri në 3.5 ton, për transportimin koshave të vegjël etj, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi);

g. Kamion Veteshkarkues me kapacitet transportues mbi 3.5 ton, për transportimin e inerteve dhe kontenierëve, pa sjellë dëmtimin e tyre, jo më pak se 2 (dy) copë, (në pronësi / me qira / porosi).

g. Mjet borepastruese, e cila duhet të jetë e kompletuar me pajisjet e pastrimit të bores dhe shpërndarjes së kripës, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi).

h. Fshesë automatike e pajisur me sistem thithës/fryrës dhe me kosh për grumbullimin e mbeturinave, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi).

i. Traktor me goma për plugim, frezim dhe diskim të rërës, jo më pak se 40 kuaj fuqi, (në pronësi / me qira / porosi).

j. Eskavator për pastrimin e lumenjve, jo më pak se 1 (një) copë, (në pronësi / me qira / porosi).

k. Fadrome për ngarkimin e inerteve, mbeturinave, dherave etj, jo më pak se 1 (një) copë (në pronësi / me qira / porosi).

**Për Mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:**

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.  
Për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të shërbimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, si dhe dokumenti me të dhënat teknike të mjetit.  
Për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të shërbimit.
- Në rast se mjetet nuk janë në pronësi apo me qira mund të paraqiten Akt Marrëveshje porositë/Kontratë Porositë. Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur (emertimin teknik), llojin, markën, nr. e shasisë, vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fitues.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku lejon AK të verifikojë mjetet dhe pajisjet para shpalljes së fituesit dhe gjatë zbatimit të kontratës.

*(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet përkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

**Argumentimi:** “Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri dhe lloji i makinerive dhe pajisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike dhe sipas kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të

mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/pajisjeve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zerat e shërbimit. Nga ana e autoritetit kontaktor vendosja e këtij kriteri është në përpjestim më natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Fondi limit, sasite, termat e references, specifikimet teknike dhe kapaciteti teknik janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 593, date 06.12.2024 sipas procesverbalit të mbajtur prej tyre.

**Njësia e Prokurimit**